



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDIM

Nr. 1, datë 15.1.2019

**PËR DISA ÇËSHTJE TË RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES
SË KONFERENCËS SË KRYETARËVE, DATË 15.1.2019**

Në mbështetje të neneve 12, 25, 26, 27 dhe 103 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Kryetarit të Kuvendit

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDOSI:

I. Përcillet për shqyrtim në seancë plenare, sipas afateve të ligjit nr. 8891/2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore parlamentare”, kërkesa e një grupi prej mëse 35 deputetësh të Kuvendit, anëtarë të grupeve parlamentare të Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim për ngritjen e komisionit hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve të pushtetit ekzekutiv dhe të institucioneve të tjera shtetërore për pajisjen e z. Gent Cakaj me certifikatë siguriedhe zbatimi i ligjit për administrimin dhe përpunimin e informacioneve pa qenë i pajisur më parë me këtë dokument, në cilësinë e tij si zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme, apo detyra të tjera shtetërore”.

II. Miratohet Programi i Punës së Kuvendit për periudhën 21 janar – 1 mars 2019 dhe i përcillet Kuvendit për votim në seancë plenare.

III. Miratohet me Kalendarin 3-javor të Punimeve të Kuvendit për periudhën 21 janar - 8 shkurt 2019, me ndryshimet e propozuara në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve dhe i përcillet Kuvendit për votim në seancë plenare.

IV. Miratohet kalendarin i paraqitjes në Kuvend të raporteve vjetore të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj me ndryshimet e propozuara në mbledhje dhe u shpërndahet për njoftim deputetëve në seancë plenare.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gramoz Ruçi

